



Pranuar / Dorezuar Primijeno / Podato Received / Delivery	09.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKINSHEK	7222	2023	1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1258/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1258/2023, të datës 06.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit: Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “Transfer” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1258/2023, e datës 06.10.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet** Vendimi me Nr.01-03-1232, i datës 21.09.2023, i Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.
- III. Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthej ankuesin në pozitën e punës Shef i Prokurimit, sipas Aktit të emërimit me Nr.04-112-119 të datës 30.03.2012.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi), më datë 06.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën

A.nr.1258/2023, kundër Vendimit Nr.01-03-1232, të datës 21.09.2023, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me pretendimin se vendimi i atakuar përmban shkeljet e pretenduara si: Vendimi tregon për tendencë të qartë ndaj ankuesit; Vendimi i atakuar cenon parimin e sigurisë juridike dhe parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme; Arsyetimi i vendimit të atakuar është dukshëm i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi-kështu nuk është vërtetuar se pozita e re është e së njëjtës kategori dhe sipas kërkesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 16.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6416/2023 të datës 06.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë, për ankuesin, të datës 31.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.10.2023, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 25.10.2023, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me Nr.04-112-108 të datës 05.02.2013; Vendimin me Nr.01-1219-2023 të datës 20.09.2023 të Zv.Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së; Vendimin me Nr.01-03-1232 të datës 21.09.2023 të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të ASK-së; Shkresën zyrtare me Nr.01-1220-2023 të datës 20.09.2023 të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të ASK-së; Tabelën e datës 06.10.2023 nga ASK-ja lidhur me shqyrtimin/korrigjimin nga DMZP; Shkresën e emërimit të ankuesit ESK-5/005 të datës 12.03.2002; Vendimin me numër protokollit 7031/2023 të datës 20.11.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill; Ankesën me numër protokollit 5111/2023, të datës 11.07.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.01-03-795 të datës 07.07.2023 të Zv.Kryeshefit Ekzekutiv; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 02.02.2023; Ankesën e ankuesit të datës 24.03.2023 e parashtruar në KPMSHCK; Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike të datës 09.02.2023; Raportin për aktivitetet e prokurimit të datës 31.01.2023; Vendimin A.nr.557/2023 të datës 23.05.2023 të KPMSHCK-së; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 02.06.2023; Planin vjetor të përmirësimit të rezultateve në punë të datës 07.07.2023; Ankesën e ankuesit për harmonizimin e koeficientit të datës 06.03.2023 tek organi i punësimit; Akt emërimit e ankuesit me Nr.04-112-199 të datës 30.03.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Komunikimet elektronike të datës 15.12.2022, 30.12.2022, 23.12.2022, 15.12.2022, 12.01.2023, 24.01.2023, 27.02.2023, 01.03.2023, 16.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësve brenda organit të punësimit si dhe personave gjegjës të përfshirë të tjerë; Shkresën zyrtare lidhur me planifikimin përfundimtar të prokurimit të datës 16.03.2023; Komunikimet elektronike të datës 16.03.2023, 12.04.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Lëndën e kontratës me Nr.01-02-277 të datës 20.03.2023; Kërkesën për tenderim të sigurimit fizik të objektit të ASK-së të datës 21.02.2023; Komunikimet elektronike të datës 18.04.2023, 13.04.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës të organit të punësimit; Vendimin me Nr.01-02-405 të datës 18.04.2023 për caktimin e Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit; Raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 10.05.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura

për rastet konkrete; Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 12.05.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura për rastin konkret; Kërkesën për rishqyrtim të datës 17.05.2023; Vendimin e datës 18.05.2023 nga ASK-ja; Komunikimin elektronik të datës 15.05.2023 të ankuesit dhe personave gjegjës; Shkresën zyrtare me Nr.04-02-590 të datës 30.05.2023 lidhur me identifikimin e autoritetit kontraktues; Kërkesën për iniciimin e aktivitetit të prokurimit për sigurimin fizik të objektit të ASK-së të datës 30.05.2023; Komunikimin elektronik të datës 29.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësit brenda organit të punësimit; Shkresën zyrtare me Nr.01-02-775 të datës 30.06.2023 lidhur me identifikimin e autoritetit kontraktues; Komunikimin elektronik të datës 29.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësit brenda organit të punësimit; Shkresat zyrtare lidhur me ftesat për tenderim të datës 30.05.2023 dhe 30.06.2023; Procesverbalin e datës 18.04.2023 lidhur me hapjen e tenderit; Vendimin me Nr.01-02-418 lidhur me caktimin e komisionit të vlerësimit të ri tenderit të datës 27.04.2023; Komunikimet elektronike të datës 26.04.2023, 24.04.2023, 18.04.2023, 31.05.2023, 19.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësit brenda organit të punësimit; Shkresën zyrtare të datës 19.05.2023 lidhur me zgjatjen e afatit shtesë prej 20 ditësh për rivlerësim të ri tenderit; Komunikimin elektronik të datës 19.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësit brenda organit të punësimit; Vendimin me Nr.01-02-662 të datës 05.06.2023 lidhur me mbi shkarkimin e komisionit nga ZKA dhe caktimin e Komisionit të Vlerësimit të Ri tenderit për ekzaminim dhe krahasim; Komunikimet elektronike të datës 05.06.2023, 31.05.2023, 19.05.2023, 05.06.2023, 31.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Vendimin me Nr.01-02-681 të datës 07.06.2023 lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve nga ZKA dhe caktimin e Komisionit për vlerësimin e ri tenderit për ekzaminim dhe krahasim; Komunikimet elektronike të datës 07.06.2023, 05.06.2023, 05.06.2023, 20.06.2023, 19.06.2023, 16.06.2023, 12.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Shkresën zyrtare lidhur me raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 26.06.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të raportit në fjalë; Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 22.06.2023; Komunikimet elektronike të datës 21.06.2023, 26.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Kërkesën për rishqyrtim të datës 26.06.2023; Vendimin e datës 29.06.2023 nga ASK-ja; Komunikimet elektronike të datës 06.07.2023 të ankuesit dhe personave gjegjës; Shkresën zyrtare me Nr.01-02-497 të datës 10.05.2023 lidhur me identifikimin e autoritetit kontraktues; Kërkesën me Nr.06-416-2023 të datës 27.04.2023 lidhur me rekrutimin e stafit të DRA tek Zyra regjionale e ASK-së; Komunikimin elektronik të datës 26.04.2023 ndërmjet udhëheqëses së personelit, ankuesit dhe personave gjegjës; Njoftimin për kontratë të datës 22.03.2023; Lëndën e kontratës të datës 04.07.2023; Komunikimet elektronike të datës 04.07.2023, 27.06.2023, 23.06.2023, 22.06.2023, 16.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Lëndën e kontratës me Nr.01-02-772 të datës 30.03.2023; Shkresën zyrtare të datës 06.06.2023 lidhur me arsyeshmërinë për ri tenderimin për angazhimin e tre konsulentëve; Kërkesën e datës 07.06.2023 për pranimin e një konsulenti profesional në divizionin e çmimeve; Kërkesën e datës 07.06.2023 për pranimin e një konsulenti profesional në divizionin e statistikave të bujqësisë; Kërkesën e datës 12.06.2023 për rekrutim të stafit në zyrën e burimeve njerëzore; Kërkesën e datës 06.06.2023 për angazhimin e stafit (një konsulenti për GIS) për përgatitjen e bazës hartografike për regjistrim të popullsisë; Komunikimet elektronike të datës 27.02.2023, 24.02.2023; Autorizimin e përfaqësuesit të datës 08.07.2023; Plotësimin e ankesës së ankuesit të datës 27.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 17.07.2023 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e ankuesit me numër ESK-5/005 të datës 12.03.2002; Përgjigjen në ankesë të datës 18.07.2023 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr.01-838-2023 të datës 18.07.2023 nga zv.Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së; Vërejtjen me shkrim me

Nr.01-384-2023 të datës 07.04.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë; Shkresën zyrtare me Nr.01-793-2023 të datës 07.07.2023 lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuesit; Shkresën zyrtare me Nr.01-799-2023 të datës 07.07.2023 lidhur me planin vjetor të përmirësimit të rezultateve në punë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka vlerësuar pretendimet ankimore të ankueist janë bazuara, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (me tej ASK), dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit me Nr:04-112-19,9 të datës 30.03.2012, është emëruar në pozitën e Shefit të Prokurimit, në Departamentin e Administratës.

Më tej, nga provat e lëndës rezulton se më datë 07.07.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, ka miratuar Planin vjetor të përmirësimit të rezultateve në punë për ankuesin, ndërsa përmes shkresës me Nr.01-793-2023 të datës 07.07.2023, ka kërkuar nga Menaxherja e Personelit nxjerrjen e vendimit për transferimin e ankuesit në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë, në pozitën zyrtar i lartë për statistika të bujqësisë dhe mjedisit, në kategorinë profesionale (profesional 1). Po në të njëjtën ditë, Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, duke u bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 01-03-7925, për transferimin e ankuesit, ku sipas pikës I të dispozitivit është vendosur që ankuesi të transferohet nga pozita e Menaxherit të Prokurimit në Departamentin e Bujqësisë dhe Mjedisit në të njëjtën kategori dhe koeficient dhe atë nga data 07.07.2023, me arsyetimin se i njëjti në bazë të vlerësimit vjetor për vitin 2022 ka treguar performancë jo të mjaftueshme për të udhëhequr me njësinë e prokurimit të këtij institucioni.

Tutje, me datë 18.07.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-838-2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr.01-03-795 të datës 07.07.2023 dhe atë sa i përket pikës I të vendimit paraprak duke e plotësuar me të dhënat lidhur me atë se ankuesi nga pozita e Menaxherit të Prokurimit transferohet përkohësisht në Departamentin e Bujqësisë dhe Mjedisit, në të njëjtën kategori dhe koeficient nga data 07.07.2023 deri me datën 06.10.2023 dhe pas kësaj periudhe i njëjti të kthehet në vendin e tij të punës.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 11.07.2023, të paraqitur kundër Vendimit Nr.01-03-795, të datës 07.07.2023 dhe Vendimit Nr.01-838-2023 të datës 18.07.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me Vendimin A.945/2023 të datës 25.08.2023, ka shfuqizuar Vendimin me Nr.01-03-795 të datës 07.07.2023 si dhe Vendimin me Nr.01-838-2023 të datës 18.07.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së statistikave të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, me detyrimin që ky i fundit të rishqyrtoj çështjen dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna sipas vendimit në fjalë.

Zv.Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në kuptim të zbatimit të vendimit të Këshillit me datën 20.09.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-1219-2023 sipas të cilit ka shfuqizuar Vendimin me Nr.01-03-795 të datës 07.07.2023 dhe Vendimin me Nr.01-838-2023 të datës 18.7.2023, me ç'rast ka obliguar Udhëheqësen e Personelit që të veproj komfor dispozitave ligjore lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuesit në interes të institucionit, në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori,

ndërsa kjo e fundit me datën 21.09.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-03-1232, sipas të cilit ankuesin nga pozita Shef i Sektorit të Prokurimit e ka transferuar përkohësisht në vendin e punës si Shef i Sektorit të Jurisprudencës nga data 20.09.2023 deri më 20.03.2024.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër Vendimit Nr.01-03-1232 të datës 21.09.2023, pretendon se transferimi i tij është arbitrar dhe në kundërshtim të plotë me legjislacionin dhe parimet themelore të shërbimit civil, po ashtu pretendon se i njëjti është transferuar nga pozita e tij aktuale e punës në një pozitë tjetër në tjetër departament. Më tej shton se vendimi i kontestuar me ankesë konsiston në shkelje të normave kushtetuese dhe dispozitave ligjore, është i bazuar në situata fiktive dhe derivon nga një proces i cili veçse është anuluar nga KPMSHCK. Nga Këshilli kërkon që ti aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar, të anulohet Vendimi me Nr.01-03-1232 i datës 21.09.2023 i Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, si dhe të obligohet zv.Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që ankuesin ta kthej në pozitën e tij të mëparshme si Menaxher i Prokurimit në afatin prej pesëmbëdhjetë ditës nga dita e pranimit të vendimit.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (*ligj ky i aplikuohet në kohën e transferimit të ankuesit*) referuar procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësve civilë, përkatësisht nenit 52 me të cilin përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 4. Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin. 5. Nëpunësi civil, gjithashtu, mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar. 6. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm sipas këtij neni.”*

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, konkretisht të nenit 6 sipas të cilit është përcaktuar se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore për përmirësim të rezultateve në punë brenda institucionit dhe institucioneve të administratës shtetërore. 2. Transferimi bëhet me kërkesë të nëpunësit ose të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë e cila miratohet nga njësia përgjegjëse. 3. Plani vjetor për përmirësim të rezultateve në punë, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni është plani i transferimeve të përkohshme në rast të nevojës së institucionit ose nëpunësit civil për përmirësimin e rezultateve në punë”.*

Në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje, nga dhe ka gjetur se i njëjti është nxjerrë mbi bazën e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 4 paragrafi 1.4 dhe 1.5 si dhe nenit 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit A.945/2023 të datës 25.08.2023 si dhe me parimet bazë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me parimin e ligjshmërisë i cili përcakton se: *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj, si dhe Nenin 8 Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme ku nënkupton se: 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.*

Për më tepër, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Kryeshefi Ekzekutiv i ASK kishte bërë kërkesë për transferimin e ankuesit për arsytet e përmirësimit rezultateve të vetë nëpunësit në këtë rast ankuesit, siç përcaktohet me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1. 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me pretendimin se ankuesi në vitin e fundit kishte treguar performancë jo të mirë në punë, ndërsa, në ri procedurë organi i punësimit në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore nxjerrë vendim për transferimin e përkohshëm të ankuesit për nevoja të institucionit sipas nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pra në riprocedurë ndryshohet lloji i transferimit të ankuesit, nga transferim për përmirësim të rezultateve të nëpunësit civil në transferim për nevoja të institucionit, ku qëllimi i këtyre transferimeve është tërësisht i ndryshëm, sepse, transferimi për përmirësim të rezultateve të nëpunësit bëhet në rastin ku nëpunësi civil nuk ka treguar performancë dhe rezultate të mira në punë dhe transferimi i kontribuon përmirësimit të nëpunësit civil, ndërsa, transferimi për nevoja të institucion bazohet në performancën e mirë të nëpunësit dhe i njëjti transferohet në një pozitë të kategorisë së njëjtë mbi bazën që të arrihen përmirësime dhe rezultate në këtë pozitë të punës. Andaj, në vlerësimin e Kolegjit veprimet e organit të punësimit në ri shqyrtim të çështjes së ankuesit, duke ndryshuar llojin e transferimit të ankuesit, janë veprime në kundërshtim me njëra tjetrën dhe si të tilla krijojnë pasiguri juridike dhe bien ndesh edhe me parimet e përgjithshme për menaxhimin zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku në mënyrë shprehimore parashihet se: *“ Parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë 1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...”*


Nisur nga gjendja e fakteve dhe konstatimeve si më lartë .Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të mos zbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1258/2023

Ardita Percuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.